

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kž. Nr. 190/2009
27 janar 2010
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligjit mbi Kompetencat"), e përbërë nga:

Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues,
Emilio Gatti, Gjyqtar i EULEX-it, si anëtar i kolegjit,
Fejzullah Hasani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, si anëtar i kolegjit,
Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, si anëtar i kolegjit dhe
Miftar Jasiqi, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, si anëtar i kolegjit;

Të asistuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Judit Eva Tatrai si procesmbajtëse, Eriona Brading procesmbajtëse e EULEX-it dhe Përkthyesit e EULEX-it, Nexhmi Rexhepi dhe Arben Pallaska;

Në prani të Prokurorit të EULEX-it Johannes Pieter Van Vreeswijk, Avokatit mbrojtës Metush Sadiku dhe Teki Bokshi, dhe të pandehurit Shkumbin Mehmeti;

Në seancat e mbajtura më 26 janar 2010, pas këshillimit të kolegjit të përfunduar më 27 janar 2010;

Në lëndën penale kundër:

Sh

M

I akuzuar për vepra penale të vrasjes së rëndë të kryer në bashkëpunim, në kundërshtim të nenit 30 paragrafi (2) pikat 2) dhe 6) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ); vrasjes në tentativë të kryer në bashkëpunim, në kundërshtim të nenit 30 paragrafi (2) pikat 2) dhe 6) të LPK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KP RSFJ-së; mbajtje të paligjshme të armëve të kryer në bashkëpunim, në kundërshtim të nenit 8.2 në lidhje me nenin 8.6 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7 në lidhje me nenin 22 të KP RSFJ-së; mbajtje të paligjshme të armëve, në kundërshtim të nenit 8.2 në lidhje me nenin 8.6 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7; dhe mbajtje të paligjshme të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafi (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

Duke vendosur mbi ankesat e të pandehurit Sh. [REDACTED] M. [REDACTED], avokatëve mbrojtës M. [REDACTED] S. [REDACTED] dhe T. [REDACTED] B. [REDACTED] dhe të atit të të pandehurit, G. [REDACTED] M. [REDACTED] të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, të datës 9 nëntor 2007;

Pas rishikimit të procesverbaleve, dëgjimit të argumenteve të Prokurorit publik, Avokatëve mbrojtës dhe të të pandehurit, dhe pas analizës së ligjeve përkatëse;

Sipas nenit 420 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga G. [REDACTED] M. [REDACTED] **HEDHET POSHTË** si e papranueshme.

Ankesa e Sh. [REDACTED] M. [REDACTED] **REFUZOHET** si e pabazuar.

Ankesat e Avokatëve mbrojtës T. [REDACTED] B. [REDACTED] dhe M. [REDACTED] S. [REDACTED] të paraqitura në dobi të Sh. [REDACTED] M. [REDACTED] **PRANOHEN PJESËRISHT**.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, i datës 9 nëntor 2007 **NDRYSHOHET** :

Cilësimet juridike të veprave penale të kryera kundër Policit ndërkombëtar P. [REDACTED] K. [REDACTED] E. [REDACTED] (UNMIK CIVPOL), dhe Policit vendor A. [REDACTED] Rr. [REDACTED] (SHPK) dhe të veprës penale të kryer kundër Policit vendor B. [REDACTED] M. [REDACTED] (SHPK) dhe përkthyesit R. [REDACTED] Z. [REDACTED] (UNMIK) (akuzat a) dhe b) në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, të datës 9 nëntor 2007) janë një akuzë e Vrasjes së rëndë dhe një akuzë e Vrasjes së rëndë në tentativë sipas nenit 30 paragrafit (2) pikës 6) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), në lidhje me nenin 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ).

Dënimi i shqiptuar për dy akuzat e Vrasjes së rëndë dhe Vrasjes së rëndë në tentativë është tridhjetë (30) vjet burgim. Dënimi unik për të gjitha akuzat është tridhjetë (30) vjet burgim.

Burgimi me dymbëdhjetë (12) vjet i shqiptuar ndaj Sh. [REDACTED] M. [REDACTED] me anë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. Nr. 126/2005, të datës 3 gusht 2005, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 30 mars 2006, është përfshirë në dënimin unik prej tridhjetë (30) vjetësh burgim.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, i datës 9 nëntor 2007 VËRTETOHET në pjesët e mbetura.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë do të mbulohen nga i pandehuri.

Sipas nenit 393 paragrafit (5) dhe (6) të KPPK-së, paraburgimi i Sh. M. vërtetohet derisa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë me anë të një Aktvendimi të veçantë.

Arsyetimi

A. Procedura

Ankesat e paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 203/2005, i datës 9 nëntor 2007:

- ankesa me kohë e të pandehurit Sh. M. është e pranueshme;
 - ankesat me kohë të avokatëve mbrojtës T. B. dhe M. S. në emër të të akuzuarit janë të pranueshme;
 - ankesa e G. M., babait të të akuzuarit, NUK është e pranueshme sepse ai nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë pasi që nuk është person i autorizuar (në përputhje me nenin 399.1 të KPPK-së në fuqi);
- 2) Seanca e kolegjit është mbajtur më 26 janar 2010 dhe shpallja publike e dispozitivit të Aktgjykimit është bërë më 1 shkurt 2010.

B. Shkelje esenciale e dispozitave të KPPK-së

Gjykimi në shkallën e parë është mbajtur në gjykatoren e ndërtesës së Burgut të Dubravës. Edhe pse një gjë e tillë ndoshta nuk rekomandohet, gjykatorka dhe seancat gjyqësore të caktuara për gjykimin e kësaj lënde, megjithatë ofrojnë kushtet ligjore të parapara me KPPK dhe garantojnë gjykim të drejtë publik të përcaktuar me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj, neni 6, ose neni 14 i Marrëveshjes mbi të drejtat qytetare dhe ato politike):

- është garantuar qasje për publikun dhe gazetarët (duke përfshirë anëtarët e familjes së viktimave dhe të akuzuarve) gjatë procedurës së gjykimit; është vërejtur prania e monitoruesve të jashtëm;
- rregullisht është arsyetuar juridikisht dhe është shpallur paraprakisht "ndërrimi i vendit" në këtë gjykatore;

- është garantuar kontakti (eventual) në mes të avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit;
- i akuzuari ka mundur që në mënyrë efektive t'i ushtrojë të drejtat e veta të mbrojtjes dhe nuk është penguar për të bërë një gjë të tillë, siç mund të shihet edhe në procesverbalin e procedurës gjyqësore.

Rrethanat konkrete (p.sh. personaliteti i të akuzuarit, numri i pjesëmarrësve, veçantia e lëndës me akuzat më të rënda kundër të akuzuarit), e kanë bërë të nevojshme marrjen e disa masave për sigurimin e funksionimit të procedurave të gjykimit nga ana e organeve kompetente (masa të sigurisë përkitazi me pjesëmarrësit dhe publikun, siç janë prania e detektorit të metalit, prania e policëve, rrethoja në mes të të akuzuarit dhe publikut, procedurat e kontrollimit, etj).

Këto masa nuk kanë qenë të asaj natyre sa të pengonin apo të kufizonin të drejtën e ushtrimit të plotë të mbrojtjes (shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor).

Përbërja e kolegjit ka qenë e ligjshme dhe kërkesa për përjashtimin është nxjerrë ligjërisht nga zëvendës kryetari i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut (që ishte në pushim) (vendimi i datës 31.08.2006 / P. Nr. 155/2006, Gjyqtari Mejdi Dehari, mbi refuzimin e kërkesës së përjashtimit, duke u bazuar në nenin 43, par. 1 të KPPK-së).

-Kolegji i shkallës së dytë nuk pajtohet me mbrojtjen se Gjykata e shkallës së parë ka mbështetur aktgjykimin e saj në dëshmi të paligjshme. Gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës penale ka bërë një arsyetim të qartë rreth ligjshmërisë së dëshmive të paraqitura (përgjimi i telefonatës së urdhëruar dhe të ekzekutuar nga organet kompetente dhe e shfrytëzuar si dëshmi nga ana e kolegjit). Gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh rregullat rigoroze të parapara për këtë lloj të ndërhyrjes në privatësinë e qytetarëve, të cilat rregulla parashihen në Kosovë si dhe ka zbatuar të drejtën dhe standardet ndërkombëtare në këtë aspekt (p.sh. neni 8.2 i KEDNj-së). Gjykata Supreme ka vepruar në përputhje me arsyetimin e bazuar ligjor të aktgjykimin të ankimuar.

- Mbrojtja nuk jep interpretim të saktë të rregullave të zbatueshme në veçanti përkitazi me përgjimin e telefonatës në mes të klientit dhe të avokatit mbrojtës. Në këtë rast, Sh. [redacted] M. [redacted] vërtet ka thirrur në telefon një avokat por ky avokat NUK ka qenë avokati i tij mbrojtës por avokat i një personi të tretë.

- Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë ligjore dhe të saktë gjatë procedurës gjyqësore që incizimet e bëra në mënyrë ligjore të lëshohen gjatë seancës publike.

Nuk ekzistojnë arsye faktike ose ligjore të bazuara të cilat parandalojnë gjykatën e shkallës së parë të veprojë në këtë mënyrë, por përkundrazi duke marrë parasysh në mes tjerash praninë e dëshmitarit, rëndësinë e kësaj dëshmie ligjore dhe parimin që gjykimi të jetë publik, të gjitha këto janë trajtuar në pajtim me ligjin.

- Në kundërshtim me mendimin e mbrojtjes, duhet të nënvizohet se ditën kur përfundoi gjykimi, gjykata e shkallës së parë ka shpallur aktgjykimin (dispozitivin sipas nenit 392.1 dhe 392.2 i KPPK-së).

Edhe pse aktgjykimi me shkrim është përfunduar disa muaj më vonë, pas datës 9 nëntor 2007, dërgimi me vonesë i aktgjykimit me shkrim tek palët nuk përbën shkelje esenciale të KPPK-së, pasi që asnjë sanksion mbi anulimin nuk është i përcaktuar me KPPK për dërgimin me vonesë të aktgjykimit, as nuk janë shkelur të drejtat e mbrojtjes për të marrë vesh vendimin e miratuar nga kolegji lidhur me fajësinë e të akuzuarit, pasi që dispozitivi tashmë ishte shpallur më 9 nëntor 2007.

I akuzuari, të gjitha palët, dhe publiku kanë qenë në dijeni që nga dita e fundit e gjykimit lidhur me vendimin e gjykatës mbi fajësinë, lidhur me dënimin që i është shqiptuar të akuzuarit dhe po ashtu kanë pranuar arsyetimin sintetik të vendimit të gjykatës.

Ky tregim i veçantë i kohës (dorëzimi i aktgjykimit me shkrim sipas nenit 395.1 të KPPK-së) në thelb parashihet si instrument menaxhimi me qëllim të përmirësimit dhe të bërjes më efikase të gjyqësisë.

- Gjykata e apelit konsideron se, për dallim nga konstatimi i avokatëve mbrojtës, shpallja e menjëhershme e dispozitivit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është shumë e kuptueshme dhe nuk është në kundërshtim me aktgjykimin me shkrim.

Nuk mund të konsiderohet si një mospërputhje e madhe, për shkak të faktit se arsyetimi i analizon të gjitha akuzat, dëshmitë e paraqitura dhe kualifikimin e tyre juridik, argumentet ligjore të paraqitura nga palët.

Nuk ka asnjë kundërshti në mes të vlerësimeve shteruese të fakteve dhe të dëshmive të dëshmitarëve apo të dëshmive të tjera ligjore, të cilat janë të sakta dhe të qëndrueshme.

Gjykata e shkallës së parë është e qartë rreth vlerësimit të gjendjes faktike, të sjelljes së të akuzuarit lidhur me gjendjen faktike, të akuzave kundër të akuzuarit ashtu siç përmenden në aktgjykim, të cilat përputhen me ato të aktakuzës së fundit të ndryshuar.

- Duke iu përgjigjur mbrojtjes së të akuzuarit Sh. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR] kolegji i Gjykatës Supreme nënvizon se mungesa e dëshmive të DREJTPERDREJTA nuk nënkupton *ipso facto* ose automatikisht parimin "in dubio pro reo".

Gjykata e shkallës së parë është në mënyrë ligjore kompetente për të vlerësuar dhe për të vendosur nëse ka dëshmi të mjaftueshme sekondare dhe mbështetëse (faktike), të cilat të ndara apo në mënyrë të bashkërenduar provojnë përtej çdo dyshimi se i akuzuari është fajtor.

Për më tepër, kolegji nënvizon se gjykata e shkallës së parë është kompetente për vlerësim të lirë, në pajtim me nenin 152 të KPPK-së, të të gjitha dëshmive të paraqitura si dhe të peshës dhe të rëndësisë së tyre dëshmuese.

- Edhe pse për keqardhje, incidenti në të cilin polici kishte me vete armën zyrtare derisa po dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit vërtet nuk lejohet me nenin 328(3) të KPPK-së, në këtë rast ky incident nuk duhet të konsiderohet si shkelje esenciale e procedurës penale, e cila do të ndikonte në lejueshmërinë e dëshmisë së tij.

Fakti që dëshmitari ka bartur armën e tij zyrtare në cilësinë e policit gjatë dhënies së dëshmisë, nuk ka pasur efekt negativ të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë dhe nuk ka penguar në asnjë mënyrë të drejtat e mbrojtjes.

Përfundim: Kolegji ankimor NUK ka gjetur, në pajtim me kriteret e përcaktuara me nenin 403 të KPPK-së, as shkelje esenciale të KPPK-së as ndonjë shkelje të KEDNJ-së, e cila do të mund juridikisht të arsyetonte anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

C. Vërtetim i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Gjykata e shkallës së parë përcaktoi drejt faktet penale të cilat ndodhën në vendngjarje (pusia (prita) e veturës së policisë së UNMIK-ut). Palët nuk e kundërshtojnë si të tillë sjelljen e vërtetuar penale të autorëve të krimit e as faktet e mbledhura në vendngjarje, por avokatët e mbrojtjes e nënvizojnë (theksojnë) se nuk ka dëshmi të përfshirjes së klientit të tyre në këto vepra penale.

Kolegji i ankesave mbetet pranë përcaktimit të fakteve dhe rrethanave faktike të vërtetuara me dëshmi ligjore të paraqitura gjatë shqyrtimeve të procedurës së shkallës së parë dhe të deklaruara në mënyrë të qartë në aktgjykimin e ankimuar (kapitulli III i aktgjykimit). Prandaj, kolegji i ankesave i referohet aktgjykimin të shkallës së parë dhe e konsideron si të mbështetur në veçanti në lidhje me përshkrimin e: krimeve, vendngjarjes, mjetet (mënyrat) e përdorura gjatë krimeve, metodologjinë e autorëve të krimit, largimi prej vendngjarjes (nëpërmes rrëmbimit të dy veturave), pasojat vdekjeprurëse për viktimat dhe në lidhje me kryerësit, kërkimin e armëve dhe gjetjet përkatëse dhe përfundimisht arrestimi i të akuzuarit.

Gjykata e shkallës së parë e vërtetoi praninë e të akuzuarit gjatë vrasjeve (zënia në pritë e veturës së policisë së UNMIK-ut). Gjykata e shkallës së parë konstaton:

“... kolegji vëren se, megjithatë nuk ekziston dëshmi e drejtpërdrejtë që Sh [redacted] M [redacted] [...] i takonte grupit të sulmuesve [...] asnjë prej dëshmitarëve që është marrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ishte në gjendje të identifikojë cilindo prej sulmuesve [...], dhe më tutje [...], dëshmitë tjera, si gjurmët e gishtërinjve, ADN-ja, fibrat nuk janë në dispozicion [...] dhe [...] pavarësisht nga mungesa e dëshmitarëve dhe dëshmive tjera, kolegji është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm që Sh [redacted] M [redacted] ishte njëri prej kryerësve”. (citata). Dënimi i dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë bazohet në përmbajtjen e thirrjeve telefonike të përgjuara prej telefonit mobil që i takonte të akuzuarit dhe të cilin e përdorte ai, identifikimin e zërit të të akuzuarit nga G [redacted] K [redacted] dhe dëshmi tjera përkrahëse dhe/ose vërtetuese. Gjithashtu radioja e konfiskuar e dorës Motorola i takonte të akuzuarit meqë në mënyrë zyrtare i është caktuar atij në

kohën kur ai ishte pjesëtar i policisë dhe të cilën kurrë nuk e kishte kthyer. Përfundimisht, armët e gjetura gjatë hetimit penal kishin lidhje me të akuzuarin.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstatoi se thirrjet telefonike siç u përshkruan në aktgjykim janë bërë nga i akuzuari me telefonin mobil të tij me këtë përmbajtje e cila do të mund të ishte e njohur në atë kohë vetëm nga i akuzuari. Prandaj, kolegji i shkallës së parë me të drejtë i është referuar kryesisht por jo vetëm njohjes së zërit nga dëshmitari G. K. Ky i fundit ishte me të vërtetë i aftë të njoh pa kurrfarë dyshimi zërin e të akuzuarit kështu që kolegji vlerësoi se ekspertiza (eventuale) e mëtejshme ishte e panevojshme. Kolegji i ankesave i referohet arsyetimit të kolegjit të shkallës së parë në lidhje me deklaratat e sakta me shkrim të dëshmitarit Z. G. K. dhe i konsideron ato si të bazuara.

Veç kësaj:

a) Kolegji i ankesave vëren se, në të vërtetë, ka informata të mjaftueshme objektive e përkrahëse gjë që konfirmon tezën se zëri i dëgjuar gjatë përgjimit të thirrjeve telefonike është zëri i të akuzuarit:

-telefoni mobil me atë numrin specifik i takonte të akuzuarit ne momentin e thirrjeve telefonike;

-telefoni mobil ishte gjetur në posedimin e tij;

-i akuzuari gjatë thirrjeve telefonike i ka dhënë informata precize pranuesit të telefonatës lidhur me shokun e tij të ngushtë A. (të quajtur gjatë pusisë) dhe pasojat (morale / familjare) të vdekjes së tij, kontrollit në shtëpinë e babait të tij, ikjes prej vendngjarjes, dhe të informatave të tjera përkatëse që kanë të bëjnë me krimet; kjo informatë ishte e saktë dhe është konfirmuar gjatë gjyqimit;

-pranuesi i telefonatës ishte “e afërmja e ngushtë e tij”, ndërsa veçantitë lidhur me lidhjen dhe ndjenjat e tyre ishin zbuluar gjatë bisedës;

-koha kur ishin bërë thirrjet telefonike ishte derisa ai ishte në arrati dhe po fshihej prej policisë (dhe të tjerëve).

b) Pavarësisht prej përmbajtjes së bisedës telefonike, koha e këtyre thirrjeve telefonike dhe të pronarit të telefonit mobil dhe numrit të tij, kolegji i ankesave vëren se dëshmitari ka pasur njohuri dhe aftësi të njoh zërin e M. për shkak të faktit se ai personalisht e njihnte të akuzuarin dhe se ai kishte me të akuzuarin një bashkëpunim relativisht të gjatë duke qenë shoku i tij i grupit në stacionin e njëjtë policorë dhe në veçanti duke qenë shoku i tij i patrullimit. Jo vetëm që ata kanë pasur biseda të shpeshta të përbashkëta por me siguri kanë komunikuar shpesh me njëri-tjetrin përmes radios dhe telefonit. Kështu që nuk mund të ketë dyshim lidhur me aftësinë e dëshmitarit që të njoh zërin e ish kolegut të tij (nga policia).

c) Akuza e mbrojtjes duke theksuar se dëshmitari G. K. është pjesë e komplotit (serb) apo veprimi hakmarrës kundër të akuzuarit, që ky dëshmitar aspak nuk është i besueshëm duke qenë “bashkëpunëtor apo spiun i serbëve”, nuk është e bazuar as me dëshmi e as me informata objektive përkrahëse.

5)- Gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka marrë në konsideratë, si dëshmi përkrahëse të prezencës së të akuzuarit në vendngjarje, faktin se radioja e tij (marrëse-dhënëse) Motorola ishte gjetur në vendin ku ishte lënë vetura Mercedes e cila ishte

rrëmbyer për të ikur. Ka dëshmi të mjaftueshme, e cila nuk është mohuar, që kjo radio e veçantë Motorola, i ishte caktuar të akuzuarit kur ai ka qenë pjesëtar i policisë. Ai si ish pjesëtar i policisë di si përdoret kjo radio dhe i di frekuencat e policisë. Nuk ka dyshim që kjo radio nuk është kthyer dhe ka qëndruar me të akuzuarin. Kur është gjetur radio ishte ende e kyçur në frekuencën e policisë kështu që është përdorur për përgjimin e bisedave policore gjatë dhe pas zënies në pritë të veturës së policisë së UNMIK-ut. Fakti që gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të vërtetoj me dëshmi të mjaftueshme që i akuzuari ka qenë i përfshirë në krimin e veçantë të vetë rrëmbimit, apo në të shtënat në patrullën e policisë duke ndjekur veturën e rrëmbyer Mercedes, nuk duhet të konsiderohet se është në kundërshtim me vlerësimin se i akuzuari ishte i përfshirë në të shtënat në veturën e policisë së UNMIK-ut disa minuta më herët. Është vërtetuar se së paku 4 sulmues u larguan prej vendngjarjes me dy vetura të rrëmbyera, njëra prej tyre ishte Mercedes, e tjetra ishte Opel në të cilën sulmuesi dhe i plagosuri A. S. ishte transportuar. Është me siguri e arsyeshme, duke e marrë parasysh përleshjen dhe faktorin shqetësues se A. S. ishte i plagosur, që Sh. M. dha radion e tij njërit prej autorëve të krimit gjatë apo pas të shtënave në veturën e policisë së UNMIK-ut. Është e arsyeshme dhe logjike të besohet se sulmuesit nuk e kanë parashikuar reagimin (të shtënat) e policit të UNMIK-ut (dhe të plagosurit A. S.) kështu që ata u larguan shumë shpejt në panik prej vendngjarjes, duke rrëmbyer aty afër veturat Opel Vectra dhe Mercedes dhe gjithashtu duke lënë veturën e kuqe Jeep Trooper së bashku me një numër armësh brenda saj. Skenari i fundit nuk kundërshton gjendjen faktike në vendngjarje dhe gjetjet në vendngjarje shkojnë në favor të këtij skenari. Gjykata e shkallës së parë ka mundur prandaj të vlerësoj drejtësisht që radio Motorola, e caktuar gjatë kohës së tij të kaluar në polici, është dëshmi përkrahëse për sulmin në veturën e policisë së UNMIK-ut por nuk është dëshmi direkt e mjaftueshme për pjesëmarrjen e tij në rrëmbimin dhe/apo sulmin në patrullën ndërhyrëse policore (ngjarja e Mercedesit). Gjykata e shkallës së parë drejtësisht theksoi më tutje se nuk është edhe e sigurt që sulmuesit kanë ardhur në vendngjarje vetëm me veturën e kuqe Jeep-Trooper kështu që nuk duhet të përjashtohet që një tjetër veturë është përdorur. Mungesa e dëshmive të mjaftueshme specifike që ka të bëjë me numrin e saktë të sulmuesve dhe numrin e veturave të përdorura e shpion gjykatën e shkallës së parë në konkluzionin e drejtë ligjor që Sh. M. nuk mund të shpallet fajtor për rrëmbim por që radio e tij Motorola është dëshmi përkrahëse e pranisë dhe përfshirjes së tij në zënie në pritë të veturës së policisë së UNMIK-ut.

- Kolegji i ankesave nuk pajtohet me argumentimin e mbrojtjes e cila deklaroi se radio Motorola i është dhënë/shitur (më herët se krimet) të ndjerit A. S. Jo vetëm që asnjë dëshmi e besueshme ligjore nuk është paraqitur nga mbrojtja por edhe informatat e besueshme dhe/ose objektive, që është paraqitur në kohë, ka të meta. Posa është paraqitur ky lloj i mbrojtjes (duke marrë parasysh personat e përfshirë, arsyetimin e dyshimtë dhe së paku të pa përkrahur objektivisht) gjykata e ankesave e konsideron këtë mbrojtje si asgjë më tepër sesa një tregim të pabazuar i cili në asnjë mënyre nuk e dëmton arsyetimin e lartpërmendur të gjykatës, të bazuar në dëshmitë objektive.

Në fund, armët dhe municioni i gjetur në mbajtje të të akuzuarit (gjatë arrestimit të tij), i gjetur në vendngjarje, i gjetur në shtëpinë e tij (familjare) dhe i konfiskuar në mënyrë ligjore, nuk janë vetëm të identifikuar drejtësisht nga gjykata e shkallës së parë si dëshmi shtesë për krime madhore (të mëdha) por gjithashtu dëshmi e drejtpërdrejtë për akuzat e posedimit ilegal të armëve në vende dhe kohëra të ndryshme. (shih aktakuzën).

D. SHKELJA E KODIT PENAL

1. Gjykata e shkallës së parë me arsyetim të drejtë dhe të ligjshëm të fakteve ka vërtetuar përgjegjësin penal të akuzuarit brenda kufijve të aktakuzës. Sjellja penale e të akuzuarit ligjërisht është cilësuar sipas ligjit në fuqi duke pasur parasysh kohën në të cilën krimet janë kryer.

2. Kolegji për ankesa është i mendimit se, megjithëse faktet dhe sjellja penale janë cilësuar drejtë dhe sipas ligjit, akuzat e ndryshme për vrasje dhe tentim vrasje duhet të konsiderohen si një akt kriminal e në këtë mënyrë edhe duhet të ndëshkohen me një dënim. Në të vërtetë, akti kriminal dhe qëllimi kriminal i të akuzuarit (i pasqyruar në dy cilësimet) është i njëjtë, që do të thotë: pusia dhe gjuajtja në veturën e Policisë së UNMIK-ut me qëllim të qartë për TË VRARË vozitësin dhe të gjithë udhëtarët. Tipi i armëve dhe karakteristikat vdekjeprurëse të municionit të përdorur, numri i plumbave të shkrepur, mënyra sesi është organizuar pusia dhe mënyra në të cilën është shkrepur në drejtim të veturës në distance të afërt, të gjitha këto elemente nuk lënë asnjë dyshim për qëllimin e vrasjes me paramendim të të gjithëve në veturë. Siç është deklaruar nga gjykata e shkallës së parë, arsyeja e kësaj vrasje apo motivi është i panjohur. Motivi nuk është në asnjë rast element thelbësor për një krim por është vetëm qëllimi për të vrarë.

3. Gjykata e shkallës së parë konsideron se sipas rrethanave rënduese të 'personit zyrtar', po ashtu edhe përkthyesi në detyrë i UNMIK-ut i cili ishte së bashku me policin në veturën e policisë së UNMIK-ut është 'person zyrtar'. Kolegji për ankesa është i mendimit se, duke u bazuar në jurisprudencën afat gjate, në ligjin e aplikueshëm (po ashtu edhe në Ligjin Penal) fjalët 'person zyrtar' duhet të zgjerohen në personin i cili zyrtarisht dhe në detyrë në përgjithësi është i lidhur konkretisht dhe faktikisht me 'personin 'zyrtar'. Arsyetimi prapa kësaj qëndron se ky person i është ekspozuar rrezikut të njëjtë si 'person zyrtar' (p.sh. shofer i 'personit zyrtar'). Në këtë rast përkthyesi rregullisht ishte caktuar në detyrën e urdhëruar zyrtare së bashku me policët. Prandaj përkthyesi, megjithëse nuk është polic, gëzon mbrojtje ligjore të njëjtë sikurse 'personi zyrtar'.

4. Gjykata për ankesa është e mendimit se gjendja e rëndë (rrezikim i popullatës – neni 30, par 2 pika 2 e LPK-së ligjërisht nuk mund të zbatohet në këtë rast prandaj kolegji për ankesa ndryshon cilësimet për vrasje dhe tentim vrasje (1 dhe 2) në këtë kuptim: lënien jashtë të kësaj rrethane kështu që mbetet vetëm rrethana rënduese nga neni 30 par 2 pika 6 e LPK.

5. Duke ju përgjigjur mbrojtjes, kolegji për ankesa thekson se pikat e ndryshme të akuzës për përdorim ilegal të armëve, në këtë rast NUK duhet konsideruar si një vepër penale si edhe nuk pajtohet me tezën se të gjitha pikat e akuzës për posedim ilegal të armëve si të tilla të 'absorbohen' nga pikat e akuzës për vrasje dhe tentim vrasje. Për shkak se secila vepër penale e posedimit ilegal ndërpritet nga konfiskimi i armëve në kohë dhe vende të ndryshme. Në këtë mënyrë e ashtuquajtura vepër penale në vazhdimësi, sikurse pohohet nga mbrojtja, çdo here ishte ndërprerë ligjërisht me fakte (konfiskimi nga policia).

Për më tepër, Gjykata përveç që thekson ndryshimin e fakteve dhe kohës, ajo po ashtu thekson edhe mendimin juridik se posedimi ilegal është qartë një krim krejtësisht i ndryshëm dhe ka element substancial moral dhe faktik të ndryshëm sesa krimet e vrasjes dhe tentim vrasjes.

6. Gjykata për ankesa pajtohet me mbrojtjen dhe prokurorin se ndëshkimi të cilin më herët e ka marrë i akuzuari me aktgjykimin e formës së prerë, duhet të kombinohet me ndëshkimin të cilin i akuzuari do të marrë me këtë aktgjykim. (Posaçërisht 12 vite burgim të shqiptuara nga Gjykata e Qarkut në Pejë 126/2005 e datës 3 Gusht 2005 e konfirmuar me vendimin e marrë nga Gjykata Supreme më 30 Mars 2006).

7. Gjykata për ankesa i referohet arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë kur sqaron ligjin e aplikueshëm dhe në veçanti ligjin më të favorshëm penal duke pasur parasysh datën e fakteve penale. Ky arsyetim konsiderohet si i bazuar. Mund të mos ketë diskutime për faktin se ligji më favorizues lejon ligjërisht gjykatën e shkallës së parë të shqiptoj 30 vite dënim me burgim duke shpallur të akuzuarin fajtor për akuzat vrasje e rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë. Mendimi i avokatit mbrojtës, që ndëshkimi maksimal duhet të jetë dënimi prej 20 vitesh, qartë është gabim. Në këtë rast dënimi maksimal që do të mund të shqiptohej do të ishte 40 vite burgim.

8. Gjykata për ankesa pajtohet me kolegjin e shkallës së parë lidhur me dënimet e sakta për tri vepra penale të veçanta të mbajtjes së paligjshme të armëve, por për krimet e vrasjes së rëndë dhe të vrasjes së rëndë në tentativë shqipton vetëm NJË dënim prej 30 vite burgim.

Prandaj kolegji për ankesa shqipton një dënim unik prej 30 vite burgim. Ky dënim përfshin dënimin e lartpërmendur prej 12 vite burgim të vendosur sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut të Pejës.

9. Për kolegjin e ankesave është e qartë se duke vendosur kështu, duke pasur parasysh krimet jashtëzakonisht të dhunshme dhe serioze, angazhimin personal në këto vepra penale, personalitetin e rrezikshëm të të akuzuarit, traumat enorme dhe të përjetshme që u ishin shkaktuar njerëzve të pafajshëm (familjeve të personave të vrarë, palëve të dëmtuara) nga i akuzuari, sipas ligjit i akuzuari tani merr një ndëshkim më të favorshëm.

10. Kolegji për ankesa nuk merr në konsideratë asnjë rrethanë lehtësuese për shkak të hetimeve dhe procedurës të gjatë penale. Kolegji për ankesa thekson natyrën komplekse të lëndës për shkak të numrit të lartë të të dyshuarve dhe të akuzuarve në këtë lëndë, për krimet e ndryshme që janë marrë parasysh gjatë procedurës penale si edhe numrin e veprimeve hetimore. Palët e përfshira, duke përfshirë këtu edhe prokurorinë, avokatët mbrojtës dhe gjyqtarët, kanë pasur nevojë për kohë dhe për shkathtësi të menaxhimit për të analizuar 90 dosje (me gjithsej mijëra fletë) të cilat e përbëjnë lëndën e gjykatës. Si konkludim, kolegji për ankesa është i mendimit se rregulla e cila deklaroi që 'secili që arrestohet ka të drejtën e gjyqimit brenda një kohe të arsyeshme' sikurse përshkruhet në nenin 29.2 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEMDNJ, nuk është shkelur në këtë procedurë penale.

E. Shpenzimet

Shpenzimet e procedurës do t'i ngarkohen ankuesit, sipas nenit 121, par. 2 të KPPK-së. Vendimi mbi shpenzimet bazohet në nenin 391, par. 1, pikën (6); nenet 99, 100, par. 2; 102 të KPPK-së.

F. Paraburgimi

Sipas nenit 391, par. 5 të KPPK-së, dënimi përfshin kohën që i akuzuari tashmë ka kaluar në paraburgim deri në dënimin e parë me burgim në shkallën e parë dhe më vonë.

Për shkak të dënimit të shqiptuar paraburgimi konfirmohet derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

E. KONKLUDIM

Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar si duhet faktet materiale por po ashtu konstaton se ligji duhet të zbatohet ndryshe ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin dhe arsyetimin e mësipërm. Gjykata Supreme e Kosovës, si kolegji për ankesa, duke u bazuar në arsyetimin e lartcekur, ka konstatuar se nuk ka pasur arsyetim të bazuar për mbajtjen e shqyrtimit.

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 190/2009
27 janar 2010
Prishtinë

Anëtarët e kolegjit:

Emilio Gatti
Gjyqtar i EULEX-it

Fejzullah Hasani
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Miftar Jasiqi
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtësja:

Guy Van Craen
Gjyqtar i EULEX-it

Judit Eva Tatrai
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Këshillë ligjore:

Ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të shpallet menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit ose pas udhëzimit për të drejtën e ankesës, por jo më vonë sesa tetë (8) ditës pas datës së shpalljes së aktgjykimit. Ankesa me shkrim mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të aktgjykimit [KPPK, nenet 430, 398 dhe 400].